



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevci Nr.8 ♦ Prishtinë ♦ Kosovë Tel: ++381 38 500 400 0 Fax: ++ 381 38 248 076 E-mail: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

LISTA PËRFUNDIMTARE E PUNËTORËVE TË CILËT I KANË PLOTËSUAR KUSHTET PËR MARRJEN E NJË PJESE TË TË HYRAVE, SIPAS NENIT 10 TË RREGULLORES SË UNMIK-ut 2003/13 (ME NDRYSHIME)

NSH. "Anamorava" Në Gjilan Fi 353/83

Sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), 20% e të hyrave nga shitjet prej privatizimit dhe likuidimit të NSH-së së lartpërmendur do t'u shpërndahet punëtorëve të NSH-së të cilët i plotësojnë kushtet e parapara.

Në vijim është dhënë lista e personave të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të 20 % prej të hyrave nga shitja dhe përvoja e tyre e punës:

Mbiemri	Emri	Përvoja e punës	Mbiemri	Emri	Përvoja e punës	Mbiemri	Emri	Përvoja e punës
Berati	Igballe	28,34	Hetemi	Avni	6,59	Kajtazi	Florina	21,09
Berisha	Xhevat	28,38	Hetemi	Bahrije	2,17	Musliu	Elmaze	24,61
Gashi	Nakije	26,62	Hoxha	Xhelal	29,17	Sadiku	Shabi	7,36
Hajdini	Fehmi	18,31	Ibishi	Esma	7,17	Selimi	Fatmire	26,09
Hamiti	Mejdi	6,59						

Sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), punëtori ka të drejtë të marrë një pjesë të 20 % të të hyrave nga shitja nëse ai/a jo ka qenë i evidentuar si punëtor i NSH-së së lartpërmendur në kohën e privatizimit ose likuidimit (cilado që ka ndodhë më parë) dhe që ka qenë në listën e pagave të NSH-së të paktën për tri vite. Punëtori i cili nuk e plotëson këtë kriter megjithatë mund të ketë të drejtë nëse diskualifikimi i tij/saj është bërë në bazë diskriminuese.

Secili person i cili mendon se ai/a jo do të duhej të jetë përfshirë në listë, që dëshiron ta kundërshtoj një ose më shumë emra në listë, ata të cilët mendojnë se stazhi i tyre i punës nuk është i saktë ose dëshirojnë të bëjnë ankesë lidhur me mënyrën e shpërndarjes së fondeve sipas nenit 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), atëherë secili prej tyre mund të parashtrorjë ankesë në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me nenin 64.6 të Urdhërësës Administrative Nr. 2006/17 në lidhje me Rregullat e Procedurës së Odës së Veçantë. Ankesa duhet të behet me shkrim dhe duhet të përmbaj (1) emrin (emrat) e individit (individëve) në emër të të cilit është parashtruar ankesa (parashtruesi (parashtruesit e ankesave); (2) adresën e parashtruesit (parashtruesve) të ankesës dhe (3) arsyet e detajuara faktike dhe ligjore për parashtrimin e ankesës me dëshmi plotësuese (në rastet kur janë të aplikueshme), kurse kopjet e dokumenteve duhet të jenë të vërtetuara nga organi kompetent. Kur ankesa është parashtruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të ankesës nga pala e tretë (p.sh avokati), pala e tretë duhet ta siguroj autorizim me shkrim me të cilin vërtetohet se është i autorizuar për të vepruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të ankesës.

Ankesat duhet të parashtrohen në Odën e Veçantë në këtë adresë:

Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës

Rr.. Bajram Kelmendi (ish Vellusha) Nr.. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë.

(Tel: +381 (0) 38/200-18-048,049,056; Fax: +381 (0) 38/200-18-047)

TË GJITHA ANKESAT NË LIDHJE ME KËTË NJOFTIM DUHET TË DORËZOHEN DERI MË DATEN 1 GUSHT 2009 PARA PËRFUNDIMIT TE ORARIT TË PUNËS SË TË NJEJTËS DITË

Për informata shtesë lidhur me atë se si duhet të parashtrohet ankesa, ju rekomandojmë që ju apo avokati juaj të shikoj nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), Kaptinën e V të Urdhërësës Administrative Nr. 2006/17 ose të kontaktoni Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës.